



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.01.2026

Numër Protokolli: 59/2026

A.nr.1906/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1906/2025, të datës 14.11.2025, të parashtruar nga ankuesja A.B, kundër organit të punësimit: Ministria Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me 53 paragrafi 1, nenin 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1906/2025, të datës 14.11.2025, e parashtruar nga ankuesja A.B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, A.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 14.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 14.11.2025, kundër Vendimit me nr.1758 të datës 08.10.2025, të pranuar me emailin zyrtar më datën 14.10.2025, të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, me të cilën është refuzuar kërkesa për kompensim pune shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme (tutje referuar MPB), ndërsa kjo e fundit, më datë 14.11.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 8128/2025 të datës 30.12.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7376/2025 të datës 14.11.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 28.07.2025 për kandidatin fitues; Kërkesën për përfitimin e shtesës për vëllim të punës për punën e caktuar si Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për përfitimin e shtesës për vëllim të punës për punën e caktuar si Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të parashtruar nga ankuesja; Vendimin me numër protokolli 1759 të datës 08.10.2025; Vendimin me numër protokolli 08/260 të datës 29.05.2025, me të cilën është themeluar Komisioni i Ankesave për Shtetësi; Emailin e datës 14.10.2025, nëpërmjet të cilës i është dorëzuar ankesës vendimi i Sekretares së Përgjithshme; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Formularin e regjistrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.12.2025; Akt Emërimit me nr.Ref: DSHAM 11/201, i datës 31.01.2013.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e datës 14.11.2025, e parashtruar nga ankuesja, A.B, kundër Vendimit me nr.1758 të datës 08.10.2025, të pranuar me emailin zyrtar më datën 14.10.2025, të Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, me të cilën është refuzuar kërkesa për kompensim pune shtesë, është e pasafatshme, ***sepse:***

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesja, sipas Akt emërimit me numër protokolli nr.Ref: DSHAM 11/201, i datës 31.01.2013, është e punësuar në pozitën e punës *Zyrtare e lartë për planifikim*, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe e njëjta është në marrëdhënie pune në këtë ministri.

Nga provat e lëndës rezulton se Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, ka marrë vendim me Nr.08/260 më datë 29.05.2025, me të cilin është themeluar Komisioni i Ankesave për Shtetësi, ku përmes këtij vendimi ankuesja znj.A.B, caktohet si Sekretare e Komisionit. Ankuesja ka paraqitur Kërkesë për përfitimin e shtesës për vëllim të punës për punën e caktuar si Sekretare në Komisionin e Ankesave për Shtetësi. Ndërsa, Sekretarja e Përgjithshme e Punëve të Brendshme, ka marrë vendim me numër protokolli 1758/2025 të datës 08.10.2025, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e parashtruar nga znj.A.B në cilësinë e Sekretares së komisionit të ankesave për Shtetësi , për përfitimin e shtesës për vëllim punës.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar më datë 14.11.2025, thekson se vendimi i kontestuar i cenon të drejtat ligjore dhe profesionale si zyrtare e MPB-së dhe nuk është në përputhje me normat dhe procedurat zyrtare, tutje ka theksuar se vendimin e Sekretares të përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme e ka pranuar nëpërmjet emaili me datë 14.10.2025, lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensim pune shtesë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ., dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja, me datë 14.11.2025 është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, nga shkresat e lëndës është vërtetuar se ankuesja me datë 14.10.2025, ka pranuar në emailin zyrtar vendimin e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensim pune shtesë, nga rrjedh se ankesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit **127 paragrafi 1** të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1906/2025.

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses A.B;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.